

Dr. Lavdosh AHMETAJ

KONTRIBUTI I MIQVE TË SHQIPTARËVE NË KONFERENCËN E PAQES NË PARIS 1919

Periodha e viteve 1918 -1920, që jemi duke trajtuar, ka bërë të mundur të dalin në pah edhe miqtë e vërtet të Shqipërisë, të cilët vepruan dhe luftuan në kushte tejet të vështira, por, edhe pse në ato kushte, ata arritën të japin kontributin e tyre në shërbim të Shqipërisë. Ata u përpoqën të bënin sqarime të ndryshme për kushtet e Shqipërisë, duke propaganduar historinë e popullit shqiptar, dhe nëpërmjet saj arritën t'i tregojnë politikës evropiane vlerat e mira të kulturës shqiptare, e njëkohësisht ata treguan përmes fakteve padrejtësitë që kishin bërë Fuqitë e Mëdha kundrejt këtij populli të pambrojtur. Kjo bëri të mundur që opinioni politik të njihej me situatën e brendshme të Shqipërisë.

Një nga shkrimtarët që ka studiuar veprimtarinë e miqve të shqiptarëve ka qenë Euxhenio Vaina, i cili është marrë me Edith Durhamin, duke e cilësuar si "heroinë e palodhur dhe mbrojtëse e çështjes shqiptare"¹.

Durhami udhëtoi për vite e vite në Shqipëri, duke studiuar vendin, duke mësuar gjuhën dhe duke folur në mënyrë elegante, e duke u afruar më shumë banorë, të çdo lloj besimi fetar, kishte arritur të shpërndante nëpër gazeta dhe revista evropiane lajme rreth qeverisjes jo tolerante në Shqipëri dhe në Ballkan, për çështje të cilat nuk kishin qenë fajet e tij.

¹ Giorgio D'Acandia, Eugenio Vaina - *La nazione albanese*. Catania 1918, f. 185.

Kishte shkuar për ndihmë tek një vend “ku mund të luftoje dhe të vdisje”², për të shpërndarë me duart e saj bukën dhe parà për luftëtarët, ilaçet për të plagosurit, për të hapur zemrën e saj të madhe grave të nënshtruara nga lodhja brutale, për të mbështetur një dorë të ngrohtë mbi ballin e nxehtë nga temperatura të një fëmije që e shikonte i çuditur dhe pa frikë.

Duke shfrytëzuar personalitetin e saj, memoriali i sugjeruar nga ajo Komitetit të Kryengritësve u mor në konsideratë nga z. Grej, ministri anglez i marrëdhënieve me jashtë. Po ashtu kishte nxitur fuqitë e mëdha evropiane që të aplikonin reforma politike në Shqipëri. Ka qenë në të gjithë Shqipërinë, përveç në Mat dhe Dibër, gjithmonë vetëm dhe pa armë. Ajo ka bërë një përshtypje të mirë në fiset, të cilat i kishte shkelur dhe nuk kishte pasur asnjëherë rrezikun më të vogël.

Edith Durhami ka shkruar për Shqipërinë këto libra: “Brenga e Ballkanit, Shqipëria e Epërme”; “Lufta për Shkodrën, Njëzet vjet ngatërresa ballkanike”; “Disa origjina, ligje dhe zakone të fiseve të Ballkanit” dhe “Nëpër tokat e serbëve”. Artikujt e shumtë të Durhamit janë botuar në The Contemporary Review; The Adriatic Review; The New Statesman; The New Europe; Affaires Etrangeres; Manchester Guardian.

Këta artikuj, të cilët u botuan nga gazeta të ndryshme shqiptare, janë punime që nxjerrin në pah njohuritë e thella për popujt ballkanik, dhe veçanërisht për popullin shqiptar. Aty analizohen probleme që shqetësonin çështjen shqiptare në vitin 1919 deri 1921, që drejtonin kritika ndaj politikës evropiane. Kështu libri “Brenga e Ballkanit” është ribotuar në fund 1918, nga Thomas Nelson Sons në qytetet Londër, Edinburg, Dublin dhe Nju Jork. Kjo ka bërë të mundur që shumë studiues të jepnin vlerësimet përkatëse, jo vetëm për veprën por edhe në lidhje me historinë e Shqipërisë, duke e parë në këtë pikëpamje, mendojmë se botimi i shume shkrimeve të miqve shqiptarë në kohën kur Shqipëria ishte duke u përjetuar historinë më të dhimbshme në Konferencën e Paqes në Paris, rimerrte vlera nga pikëpamja e rivlerësimit të çështjes, përkrahjes që i jepej çështjes shqiptare.

² Po aty, f. 187 (Ajo ishte një nga ato gra shenjtoze dhe heroike angleze, e besimit të krishterë, e cila u rrëmbye nga bukuria e një misioni humanitar kundrejt kësaj race bujare shqiptare që ishte në agoni prej qeverisjes së keqe të perandorisë turke).

Nëpërmjet shkrimeve të Durhamit gjendej mundësia për të informuar opinionin politik evropian mbi politikën e shteteve fqinjë, të cilët punonin pareshtur me anë të propagandës së tyre për të bindur popullsinë shqiptare të ndërronte bindjet mbi përkatësinë kombëtare. Durhami theksonte se lexuesi evropian besonte se “turku dhe të gjithë myslimanët janë të këqij”³, kurse maqedonasit e me ta bashkë të gjithë të krishterët ishin të virtytshëm. Pra nëpërmjet këtyre ideve dhe njoftimeve ajo besonte se do të ndihmonte “opinionin evropian të kuptonte se këto telashe janë me origjinë raciale e jo fetare”⁴.

Durhami ishte një nga miqtë më të sinqertë të Shqipërisë. Ajo arriti të kuptonte fisnikërinë shqiptare dhe fatin e këtij kombi. Kjo gjë bëri të mundur të zbulonte ndjenjën kombëtare shqiptare dhe të demaskonte lojën e egër, të kurdisur, në kurriz të këtij populli nga shovinistët fqinjë dhe Fuqitë e Mëdha. Ajo nuk u mjaftua thjesht me tërheqjen e vëmendjes së politikës evropiane, por edhe duke qenë vetë aktive. Ajo kishte ndërhyrë pranë Ministrisë së Jashtme të Anglisë në mbrojtje të çështjes shqiptare. Duke organizuar fushata ndihmash, demaskoi krimet e serbëve ndaj popullsisë shqiptare dhe sensibilizoi opinionin publik evropian, lidhur me politiken e Fuqive të Mëdha në Shqipëri. Kështu nëpërmjet gazetës “Albania” 15 gusht 1919, ajo analizonte aleancat e Fuqive të Mëdha dhe ekzistencën e Shqipërisë jashtë këtyre aleancave, të cilat e kishin menduar me kujdes përjashtimin e saj nga aleancat e vendeve Ballkanike. “Shqipëria ishte sakrifikuar për faktin sepse ajo nuk i kishte pëlqyer Ruisë, sepse ajo nuk kishte dashur shtete që nuk ishin ortodokse. Franca duke ngritur Greqinë, në Ballkan, si një fuqi detare kundër Italisë deshi të bënte të mbrojturit e saj dhe njëherësh kishte radhitur Serbinë si anëtare të re të aleancës Franko-Ruse. Ndërsa Italia kishte veglën e saj, vjehrrin e saj Malin e Zi duke shpresuar tek mosmarrëveshja Serbe – Malazeze”⁵ dhe më poshtë vazhdonte “Fuqitë e Mëdha kishin gjetur mjetet e nevojshme për të krijuar situatë jo të këndshme për Shqipërinë dhe ishte Esat Toptani i cili kishte asasinuar Riza Husein i cili përdha qytetin e Shkodrës”⁶. Ndërsa në letrën që i dërgonte Mihal Turtullit të 20 tetor 1919, ajo i tregonte se, Komiteti

3 Giorgio D’Acandia, Eugenio Vaina - *La nazione...*, f.186.

4 Po aty, f.187.

5 Gazeta “Albania”, Worçerster, 15 gusht 1919, nr.68, f.1.

6 Po aty.

Ballkanik e kishte thirrur për të prezantuar çështjen shqiptare “ Siç e dini Komiteti Ballkanik ishte egërsisht kundër Shqipërisë gjatë shumë viteve dhe më kanë lejuar shumë rrallë të asistoj në seancat e tyre”⁷.

Në vitin 1920 botohet vepra “Njëzet vjet ngatërresa ballkanike”, pikërisht në Londër e më pas u përkthye në gjuhën gjermane, duke u shoqëruar edhe me idetë e veprës dhe në kohën e duhur. Ajo në mënyrë protestuese deklaroi largimin e saj nga Mali i Zi: “Unë u largova duke e lënë Cetinën të ziente në lëngun e vet”⁸. Ajo kërkonte antropologji e jo komplete dhe u zhduk nga skena për të ardhur në malet e Shqipërisë, lufta dhe refugjatët do të ishin objektet e saj antropologjike të viteve të mëvonshëm.

Ajo stigmatizonte diplomatët e të prapaskenave në kurriz të popullit shqiptar. “E çfarë mund të presësh - theksonte ajo - kur të tillë njerëz punojnë në qarqe diplomatike dhe ndihmojnë për të tendosur telat edhe më tepër”⁹. Sarkazma e saj nxjerr në pah planet dhe intrigat e konsujve të shteteve fqinjë dhe Fuqive të Mëdha. Ja si e analizonte ajo, këtë nëpërmjet gazetës “Dielli” 15 gusht 1919, duke ju referuar një fshatari shqiptar, të cilin e quante terzhumanin e saj, që i kishte thënë: “Zonjës Fuqitë e Mëdha janë si grumbuj kusarësh ditën zihen e natën të bashkuar që te tërë dalin tokë që të vjedhin”¹⁰. Duke qenë e shqetësuar për çka treguam më lartë, ajo kërkonte midis Fuqive të Mëdha mundësinë e një zgjidhje të pranueshme. Kështu nëpërmjet letrës së dërguar Mihal Turtullit më 27 tetor 1919, duket se kishte frikë se “nëse nuk rregullohej shpejt Shqipëria me Italinë, Franca do të tërhiqte trupat e veta dhe serbët e grekët do të hyjnë në Korçë dhe Skutari”¹¹ dhe rekomandonte që e vetmja gjë ishte të limitohej Italia për 25 ose 30 vjet dhe të “rregullojmë lirinë e gjuhës, mësimin. Por Shqipëria do të humbasë akoma terren, kam frikë”¹².

Ajo ka meritën e veçantë sepse diti në kohën më të vështirë të kombit shqiptar, kur shtrohej çështja e ekzistencës së tij, të shpjegonte nëpërmjet letërkëmbimeve mundësinë e zgjidhjes dhe rrugët që duhej

7 AQSH . F.435 , viti 1919 , dosja .6 , f.5.

8 Gazeta “Albania” , Worçresrser, 15 gusht 1919, nr.68, f .1.

9 Po aty.

10 Po aty.

11 AQSH.F.435,viti 1919, dosja nr.6, f.9.

12 Po aty.

të ndiqeshin për të dalë nga situata.

Ajo studioi me vëmendje rastet e shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve dhe mizoritë e shovinistëve, duke treguar shtrirjen etnike të popullsisë shqiptare që nga lashtësia deri në kohët moderne. Por nuk duhen harruar efektet politike të punës së saj në kohën që Shqipëria ishte e mbyllur dhe informacioni vështirë se publikohej për Shqipërinë.

Vepra e Durhamit, shkruante nga Londra Xhon Hoxhson në vitin 1928, “është një magazinë thesaresh të mrekullueshëm të dokeve e të zakoneve, të paktën për lexuesin jo profesionist. Forca tërheqëse e librit shtohet nga cilësia anekdotike e gjithashtu vepra përshkohet nga një nostalgji personale për udhëtimet që autorja nuk do t’i bënte më kurrë”¹³.

Eriksoni është shquar si një nga miqtë më të vyer të shqiptarëve nëpërmjet veprave dhe iniciativave të ndërmarra jashtë Shqipërisë, në institucionet e politikës evropiane dhe atyre amerikane. Ai duke njohur mirë historinë e kombit shqiptar, ka shprehur në mënyrë konkrete disa ide lidhur me pavarësinë e Shqipërisë. Kështu gjejmë të sintetizuara katër pika nga Telford Eriksoni në formën e një programi në favor të Shqipërisë, të nënshkruar nga vetë ai: “Program veprimi në favor të Shqipërisë, nënshkruar nga Telford Erickson”¹⁴, i cili përshtatej në këtë formë:

1. Kërkesë Lidhjes së Kombeve për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe pranimin e saj në Lidhje si anëtare.

2. Angazhimi për të siguruar përkrahjen morale të Amerikës në këtë kërkesë.

3. Të kërkohet një komision i lartë amerikan pranë Qeverisë Shqiptare, nën varësinë e Lidhjes së Kombeve për një periudhë prej pesë vjetësh.

4. Të punohet për bashkimin e të gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen, në mënyrë që të kenë mundësi që ata të formojnë një udhëheqje politike për qeverisje sa më të mirë.

Herberti ishte biri i një prej familjeve të mëdha aristokrate angleze, i cili pjesën më të madhe të kohës së para Luftës së Parë Botërore

13 Edith Durham - *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, 8 Nëntori, Tiranë 1999, f. 7.

14 AMPJ. Telford Erickson (signerd), viti 1919, dosja 1, f. 207 (203.430) (daktilografuar) (frëngjisht).

e kishte kaluar duke udhëtuar nëpër Perandorinë Osmane, duke parapëlqyer kushtet e rrezikshme dhe të paretshme. Ai fliste rrjedhshëm gjuhë të ndryshme, ishte njohës i mirë i turqishtes dhe shqipes, e kjo e kishte ndihmuar të njihte mirë kulturën dhe historinë e shqiptarëve. Nëpërmjet Margaret Makmilanit e njohim të ishte “agjent pa pagesë i ministrisë së Jashtme Britanike ... dhe vëlla gjaku i çdo komiti shqiptar”¹⁵. Për besueshmërinë dhe ndihmën e çmuar që u kishte dhënë shqiptarëve, ata i afruan atij fronin mbretëror, por ai nuk e pranoi.

Herbert ishte President i Komitetit Anglo-Shqiptarofil në Londër¹⁶, qëllimi i të cilit ishte të bënte prezentë çështjen shqiptare në opinionin politik evropian, në mënyrë që shqiptarët të fitonin pavarësinë dhe të formonin shtetin e tyre. Edit Durham ishte sekretare e tij. Ai, duke qenë deputet në parlamentin britanik, kishte prezantuar gjendjen e Shqipërisë dhe tendencat e qarta të politikës së shteteve fqinjë kundër saj: “Unë jam i bindur - kishte deklaruar ai - se shqiptarët u asgjësuan në mënyrë sistematike përgjatë kufirit të jugut, pikërisht nga ata që ishin betuar se ishin miqtë e tyre, përveç fatkeqësive të pësuarra, Shqipëria ka vuajtur dhe po vuan se bota nuk di se ç’po ndodh në këtë pjesë të Ballkanit”¹⁷.

Për ta konkretizuar idenë e Herbertit, po i referohemi ngjarjes në fshatin Kodër afër Tepelenës, ku në fillim të Luftës së Parë Botërore ushtria greke kishte detyruar banorët të futeshin në kishën e fshatit, burra, gra e fëmijë, gjithsej 195 vetë. Ishte vendosur mitralozi tek dera e kishës dhe oficeri kishte urdhëruar të qëlloheshin, duke i varur të gjithë. Por, sipas shumë burimeve, nuk kishte mjaftuar vetëm kjo, por të varurëve u kishin prerë kokat dhe i kishin varur përqark mureve të kishës. Gjenerali holandez De Eeir kishte shkuar personalisht tek vendi i ngjarjes dhe arriti të fotografonte këtë akt barbar të ushtrisë greke.

Duke u nisur nga disa burime, duket se shqiptarët e konsideronin Herbertin si një mik i cili në forma të ndryshme u kishte shërbyer si një pikë referuese shqiptarëve për hallet dhe shqetësimet e tyre. Këtë gjë e vërteton letra e Aqif Pashës dhe e Lef Nosit, të cilët ia dërgonin Aubrey Herbertit lidhur me masakrën e serbëve në Dibër, e cila ishte

15 Margaret Makmilan - *Paris 1919*. Tiranë 2006, f. 42.

16 *Kujtime për luftën çlirimtare për vitet 1918-1920*, Tiranë 1970, f. 39.

17 Xhorxh.F.Wiliams - *Shqiptarët*. Biblioteka: Miqtë e Shqipërisë. Tiranë 1999. f. 79.

shoqëruar me shpërnguljen e 200 familjeve, duke lënë pasuritë e tyre dhe duke u larguar vetëm me rrobat e trupit për në qytetin e Tiranës dhe atë të Elbasanit, ata ishin tjetërsuar në refugjatë të vërtetë, por me një ndryshim, refugjatë në vendin e tyre. Ja çfarë theksohet në këtë letër: “Ne po bëjmë gjithçka mundemi, por nuk mund të ndihmojmë mijëra refugjatë në këtë dimër vetëm duke zgurdulluar sytë mbi të vuajturit. A mund të bëhet diçka për të shpëtuar shtëpitë dhe mallrat e për të siguruar nevojat e tyre?”.

Por ajo çka tërheq më shumë vëmendjen në këtë letër, është fakti se shqiptarët me anë të Herbertit kërkonin t’ia bënin të ditur edhe publikut anglez, i cili nëpërmjet ndihmave humanitare mund të kontribuonte për të zbutur krizën e cila kishte për shkak barbarinë serbe. Por një rrugë më e efektshme që mund të ndiqej për këtë problem, duhet të ishte edhe ajo diplomatike, e ja si theksohet në letër: “Për të ndihmuar refugjatët edhe në rrugë diplomatike, për të bërë të mundur kthimin e vuajtësve të varfër sa më shpejt të jetë e mundur në shtëpitë e tyre shëndoshë e mirë”¹⁸.

Herberti, duke u nisur nga dokumente të tjerë arkivorë, duket se është i lidhur edhe me Turtullin, të cilin e mbante në dijeni lidhur me vështirësitë që haste Mehmet Konica për të lëvizur nga një kryeqytet në tjetrin. Herberti, duke pasur mundësinë e lëvizjes së lirë, kërkonte të ndihmonte edhe Konicën në mënyrë që ai të ishte sa më i efektshëm në punën e tij politike dhe patriotike, e “shpresoj që kur të jem në Paris - thotë Herberti - të kem mundësinë ta rregulloj për mikun tim Mehmetin të shkojë në Paris dhe ndoshta më vonë në Itali, por jam i pirur të mendoj se mund të ketë disavantazhe për sa i përket shkuarjes së tij në Zvicër në këtë moment”. Me të arritur në Londër, ia kishte dalë të bënte një intervistë me Lord Robert Sesilin, ndërsa në Ministrinë e Jashtme kishte takuar një numër të madh njerëzish me funksione në qeverinë e Britanisë së Madhe.

Herberti kishte arritur të bënte takime me shumë figura politike të shteteve të Evropës Perëndimore, si me kryeministrin anglez, “dhe - shprehet ai - unë shfrytëzova mundësinë për të shkuar në Ke D’Orse, ku unë u takova me njerëzit përgjegjës të politikës. Ata më siguruan që

18 AQSH. F. 737, Elbasan, shtator 1913, d. 4, f. 3 (Aubrey Herbert, Travelers Club London).

nuk do të ketë vështirësi në rrugën e Mehmetit për në Paris”¹⁹.

Mehmet Konica, përmes letrës që i dërgonte një mikut të tij më 11 maj 1918, pohonte se kishte këmbime letrash me Herbertin dhe deklaronte se kishte këmbyer ide dhe mendime të vazhdueshme me “mikun tim për një çështje shumë të rëndësishme, siç ishte ajo e Ismail Qemalit”. Konica ishte i mendimit se nuk mund të bashkëpunojmë me të për arsye që i kishte paraqitur në letrën e 1 prillit. Por, duke u nisur nga interesa më të mëdha dhe “për arsye që ne shqiptarët nuk duhet të bënim figurë të keqe pasi kjo do të çonte në prishjen e punëve të mira që kishim nisur, ne mundemi, në një moment të fundit, të biem përkohësisht dakord me Ismail Qemalin për të paraqitur vetëm një memorandum në Konferencën e Paqes”, por ajo çka na intereson në qëndrimin e Herbertit është fakti se “miku ynë është i kënaqur nga kjo zgjidhje”²⁰. Kontributi i Herbertit duket se nuk është i vogël edhe në ndihmesën që dha për t’i bërë të mundur delegacionit shqiptar të shkonte në Paris në mënyrë të rregullt dhe zyrtare. Kjo vërtetohet edhe prej letërkëmbimit të Herbertit me H. S. Spenserin lidhur me çështjen e pasaportave për shqiptarët, sepse ende Qeveria Shqiptare nuk ishte njohur formalisht prej Anglisë, e për pasojë kishte dalë e nevojshme të përcaktohej në Forin Ofis nëse pasaportat e lëshuara prej autoriteteve shqiptare “janë të pranueshme sipas dispozitave të Rendit për të huajt, lidhur me hyrjen e shqiptarëve në këtë vend”. Në përgjigjen e letrës së 25 majit 1918, H. S. Spenseri e njofton A. Herbertin se Ministria e Brendshme Angleze kishte vullnet të mirë për të pranuar pasaportat e lëshuara në emër të Qeverisë Shqiptare, prandaj ai ishte duke i udhëzuar nëpunësit e kontrollit të pasaportave jashtë vendit, përfshirë këtu edhe ata të Parisit, që të pajiseshin me viza pasaporta të tilla. “Unë nuk parashikoj që tash e mbas të ketë shqetësime lidhur me pasaportat e shqiptarëve, por po doli ndonjë pengesë në të ardhmen, lutem të më vini në dijeni”²¹.

Nëpërmjet “Diellit” njoftohemi se shqiptarët kanë pasur edhe një mik të nderuar, prof. Luis Dyfur, i cili ka shkruar më 1919 nëpër gazetata e Evropës shumë shkrime. Emri i tij ka mbetur i paharruar “në zemrat tona - shtonte “Dielli” - se me të vërtetë miq dhe mirëbërës të

19 AQSH. F. 737, v. 1917, d. nr. 2, f. 2.

20 AQSH. F. 435, v. 1918, d. nr. 6, f. 94.

21 AQSH. F. 35, v. 1918, d. nr. 36/4, f. 792.

tillë të Shqipërisë janë të rrallë²². Në një letër që u drejtonte shqiptarëve të Amerikës, ai u lutej të dërgonin dorëshkrime, libra, broshura dhe manuale të vjetra, të cilat mund të flisnin për historinë e Shqipërisë, e pastaj këto materiale ai i studionte duke i shfrytëzuar si burime për punimin që kishte në dorë, me titull: Shqipëria dhe shqiptarët, e drejta në histori²³.

Dyfuri kishte lindur në Normandi të Francës më 19 shkurt 1870. Me pasionin e mësimit të gjuhëve të huaja, pasi kishte mbaruar kolegjin: Grand College des Freres de la Doctrine Chretien, udhëtoi për në Evropë që të studionte për filozofi. Ai në vitin 1888 fitoi medaljen e argjendtë prej Institutit të Shoqërisë Moderne të Francës, duke qenë njohës i disa gjuhëve, si frëngjisht, italisht, anglisht, spanjisht, portugalisht, rumanisht, esperanto, malteze, filipinishte, katalane, moldo-vllahe.

Kjo kulturë kaq e gjerë i kishte bërë të mundur të binte në kontakt edhe me gjuhën shqipe, të cilën e studioi mirë në ndërtesën e gjuhës, rrënjët e fjalëve, dhe pas një pune vigane, duke kërkuar fjalët edhe atje ku nuk gjendeshin, edituesi i Zgjimit të Shqipërisë nxori një fjalor shqip prej 17.000 fjalësh, një Gramatikë shqipe për frëngjt dhe shqiptarët²⁴. Shqiptarët, duke parë punën e prof. Dyfurit, i luteshin Perëndisë, përmes gazetës Dielli, që ajo t'i falte jetë të gjatë, dhe t'i shtonte kurajën këtij luftëtari trim, i cili përpiqej me të gjitha mënyrat demokratike për të bërë të mundur zhvillimin dhe zbukurimin e literaturës dhe gjuhës shqipe. Po sipas kësaj gazete, ai është përpjekur edhe për të ruajtur tërësinë kombëtare shqiptare. Portretin e tij kjo gazetë e ka paraqitur në faqen e parë të saj më 4 prill 1919, pikërisht në ato momente kur tërësia kombëtare shqiptare ishte duke u diskutuar në Konferencën e Paqes në Paris.

Ndihma e miqve të shqiptarëve duket edhe më mirë kur çështjen e shohim edhe në një këndvështrim tjetër. Shqiptarët nuk ishin optimistë për zgjidhjen e krizës edhe për faktin se ata kishin bërë pak propagandë dhe, për pasojë, politika evropiane ishte më mirë e informuar nga propaganda e kundërshtarëve të Shqipërisë. Ja çfarë theksonte në atë kohë Dielli: “Çështja jonë nuk mund të zgjidhet në favorin tonë

22 Dielli, Boston Mass, Friday, 4 prill 1919, No. 1490, f. 1. Editori I - Zgjimi i Shqipërisë, Editor Bahri Omari.

23 Po aty, f. 1.

24 Po aty, f. 2.

sepse ne kemi bërë pak propagandë për çështjen tonë në të huajt, të cilët janë ushqyer më tepër me propagandat e armiqve tanë. Të huajt s'kanë pasur rasjen të këndojnë vepra prej shqiptarësh, përveç disa veprave të mirëdashësve të Shqipërisë, të cilat s'kanë qenë të mjafta për të bërë të njohur pikëpamjet e shqiptarëve, kurse nga ana tjetër, veprat e armiqve tanë kundër Shqipërisë kanë qenë të tepërta”²⁵. E pikërisht kjo situatë në të cilën ndodhej propaganda shqiptare na detyron që të jemi më kërkuar ndaj kontributit të miqve të shqiptarëve, të cilët, të shtyrë nga ndërgjegjja dhe kultura e tyre, arritën të ndihmojnë në njohjen e çështjes shqiptare, nëpërmjet gjuhës së shteteve të mëdha të cilët diktonin politikën globale.

25 Dielli, Boston Mass., Monday, 28 prill 1919. No. 1509, f. 2 - Çështja shqiptare do vonohet, Editor Bahri Omari.

Dr. Lavdosh AHMETAJ

SUMMARY

FRIENDS OF ALBANIA CONTRIBUTION ON PARIS PEACE CONFERENCE 1919-1920

This topic pinpoints one of acute problems of Albanian history, the fact Albania has had no much friends. In this view we treated their contribution through tangible evidence, which have been presented into this subject matter.

Our assessment noted Edith Durham's contribution for she managed to shed light into European opinion, especially political one that proved decision-making to future of Albania in 1919-1920. Durham's contribution through her articles was found on newspapers of the time published either in Albania or in Albanian Diasporas. This contribution reflects not only human empathy towards Albania, but mostly realistic approach. Therefore, it is interesting her analysis explaining contradictions between the Great Powers resulting in consequences for Albania. For Albanian part this presented invaluable contribution to the Albanian cause in 1920.

Also, Telford Erikson's contribution is of great interest. Mr. Erikson had prepared a program conceptualized in four points over possibility of creating an Albanian unified government making it legitimate for recognition and assistance of the League of Nations, in particular eligible for US aid. Another foreign personality Mr. Herbert, whose active approach resulted with creation of English-Albanian Committee of London aimed to present Albanian question to European political opinion.

Therefore, in circumstances with no information provided on Albanian events and developments in European politics, this committee played significant role for Albanian cause.

